



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 461/25

Data 13.06.2025

Prishtinë, 12 qershor 2025

Kodi i ZRRE-së: V_2724_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 Nenin 25 dhe Nenin 26 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Nenin 3 par. 1 nënpar. 1.72, Nenin 37 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Nenin 124 par.6 nënpar. 6.3, nenin 136 dhe nenin 138 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe kërkesën e Partisë Demokratike të Kosovës(PDK), lidhur me kundërshtimin administrativ kundër Njoftimit publik mbi liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë,

në seancën e mbajtur më 12 qershor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** si i palejueshëm kundërshtimi administrativ i paraqitur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), përfaqësuar nga z. Memli Krasniqi, ndaj njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 12 mars 2025.
- II.** Njoftim publik mbi liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë nuk përbën akt administrativ individual dhe nuk krijon efekte juridike individuale për palën parashtruese, andaj nuk është i kontestueshëm përmes kundërshtimit administrativ sipas nenit 124 par. 6 nënpar. 6.3 dhe 136 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- III.** Vendimi i Bordit të ZRRE-së, për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin e Shërbimit Universal, i cili përbën bazën për zbatimin e liberalizimit të tregut, është akt përfundimtar administrativ, i miratuar nga një organ kolegjal i pavarur, dhe si i tillë mund kundërshtohet vetëm në gjykatën kompetente, sipas Nenit 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin për Energji.

A R S Y E T I M

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) me datë 30.05.2025 ka pranuar kërkesën – kundërshtimin administrativ të paraqitur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), përfaqësuar nga z. Memli Krasniqi, ndaj njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 12 mars 2025.

ZRRE është institucion i pavarur i përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin për Energji, dhe Bordi i saj është organ vendimmarrës kolegjal, i cili nxjerr akte administrative përfundimtare.

Mbështetur në nenin 25 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, kundër vendimeve të Bordit të ZRRE nuk parashihet mjet juridik administrativ, por vetëm padi në gjykatën kompetente, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e publikimit sipas Ligjit për Konfliktet Administrative.



Dispozitat e Nenit 124 par. 6 nënpar. 6.3 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktojnë qartë: “Mjetet juridike administrative nuk mund të ushtrohen nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”

ZRRE konsideron se Njoftimi i kundërshtuar nuk është akt administrativ, pasi që Njoftimi publik i datës 12 mars 2025 nuk përmban urdhër detyrues individual, nuk cakton të drejta apo obligime konkrete ndaj subjektit PDK apo ndonjë konsumatori në mënyrë individuale, dhe nuk është akt i ekzekutueshëm në vetvete.

Njoftimi publik mbi liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë është akt real në kuptim të nenit 69 dhe 136 të LPPA – pra, një veprim informues, i cili reflekton një obligim ligjor detyrues të përcaktuar me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe me Vendimin e Bordit për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin me Shërbim Universal me të cilën është vendosur për vazhdimin e implementimit të hapjes së tregut për konsumatorët që i plotësojnë kriteret të kalojnë në treg të hapur dhe të përfitojnë nga mundësitë konkurruese sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili është akti përfundimtar me efekt juridik.

ZRRE konsideron se rruga e duhur juridike bazuar në nenin 25 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, është që vendimet e Bordit të ZRRE mund të kundërshtohen vetëm në gjykatën kompetente, përkatësisht brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e publikimit ose njoftimit të vendimit. Prandaj, ushtrimi i mjetit juridik administrativ (kundërshtim administrativ) në këtë rast është proceduralisht i palejueshëm, siç parashihet në mënyrë të qartë në nenin 124 par. 6 nënpar. 6.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Akti i pretenduar si kontestues nuk prodhon pasoja të drejtpërdrejta juridike Njoftimi i publikuar më 12 mars 2025, i cili njofton për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe vendimeve të ZRRE-së lidhur me hapjen e tregut të energjisë për konsumatorët që nuk përmbushin kriteret për furnizim me shërbim universal, nuk është akt me efekt të drejtpërdrejtë individual ndaj ndonjë subjekti specifik. Prandaj, ai nuk është objekt i ligjshëm për kundërshtim administrativ sipas Nenit 136 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj, ZRRE konsideron se vetëm Vendimi mbi të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Universal, si akt administrativ përfundimtar, do të mund të kontestohet në gjykatë – brenda afatit ligjor – por parashtruesi i kundërshtimit nuk e ka bërë këtë.

ZRRE vlerëson se parashtruesi i kundërshtimit Partia Demokratike e Kosovës si subjekt politik nuk ka legjitimitet të drejtpërdrejt për kontestim, pasi që nuk është konsumator dhe nuk është subjekt i drejtpërdrejtë që preket nga vendimi mbi liberalizimin e tregut të energjisë elektrike.

Dispozitat e nenit 14 par.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktojnë që personat juridikë mund të përfaqësojnë interesa kolektive vetëm nëse ato janë objekt i drejtpërdrejtë i cenimit juridik – çka në këtë rast nuk ndodh, pasi akti real nuk prodhon efekte juridike konkrete as për PDK si parti politike.

ZRRE konsideron se pretendimet e parashtruesit janë të pa mbështetura, referuar pretendimit të një raporti nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili nuk e cenon vlefshmërinë e vendimit të Bordit të ZRRE-së, përderisa kompetenca për të vlerësuar përmbushjen e kushteve për liberalizim të tregut i është deleguar ZRRE-së, me Ligj të Rregullatorit për Energji dhe me Ligjin për Energjinë Elektrike.



Gjithashtu referenca ndaj analizave të OEK ose opinionit të Avokatit të Popullit janë vlerësime publike, por nuk kanë efekt pezullues dhe nuk përbëjnë bazë ligjore për ndalimin e zbatimit të një akti përfundimtar, pasi që vendimet e Bordit të ZRRE janë të zbatueshme menjëherë dhe nuk i nënshtrohen kurrfarë rishqyrtim, përveç atij gjyqësor.

ZRRE përfundimisht konsideron se ka zbatuar drejt dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin për Energji ku përcaktohet se: "Të gjitha vendimet merren në mënyrë autonome dhe të pavarur nga çfarëdo organi politik apo publik, apo nga çfarëdo ndërmarrjeje publike a private, dhe Vendimet e Bordit kanë efekt të menjëhershëm dhe nuk i nënshtrohen kurrfarë rishikimit apo vetoje nga organet tjera publike, përveç shqyrtimit gjyqësor.

Prandaj, ZRRE konsideron se bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendim, mjetet juridike administrative nuk mund të ushtrohen kur ligji i veçantë përcakton se kundër vendimit të organit kompetent nuk mund të ushtrohet ankesë apo kundërshtim administrativ, përfshirë rastet kur vendimi është i formës së prerë në procedurë administrative dhe si i tillë është i kontestueshëm vetëm në gjykatën kompetente.


Bordi i ZRRE pas vlerësimit të kundërshtimit administrativ të paraqitur, shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, analizimit të argumenteve të parashtruesit si dhe të akteve përkatëse të ZRRE-së, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi – veçanërisht në nenin 124 paragrafi 6 nënpar. 6.3, nenin 136 dhe nenin 138 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenet 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin për Energji – konstaton se kundërshtimi administrativ është i palejueshëm dhe i pabazuar, dhe si i tillë refuzohet, ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.


IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues,


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.